



LESNA

DYER DHE DRITARE

PËR NE

LESNA shpk është fabrika më e madhe në rajon për prodhimin e dyerve dhe dritareve e cila filloi aktivitetin e saj 50 vite më parë dhe që nga atëherë, brendi LESNA është më i njohuri dhe më i përdoruri në industrinë e prodhimit të dyerve dhe dritareve.

Çdo gjë që bëjmë është e përqëndruar në angazhimin tonë maksimal për përmbushjen e të gjitha nevojave dhe ofrimin e shërbimit më të mirë të mundshëm për klientët tanë, duke siguruar një vend pune të sigurtë dhe të shëndetshëm për punonjësit dhe duke kontribuar në cilësinë e jetës në komunitetet ku ne operojmë.

LESNA ka zgjeruar aktivitetet e saj në tërë territorin e Kosovës, në Preshevë, Shkup dhe Tiranë.

Me anë të investimeve të vazhdueshme kemi krijuar një bazë prodhuese e cila është në mesin e më të rejave, më efikase dhe me teknologjinë më të avancuar në industrinë e prodhimit të dyerve dhe dritareve dhe është kompania lidere për prodhimin e dritareve nga druri në Kosovë.

Lënda e parë e drurit është 100% e aprovuar nga FSC (Forest Stewardship Council) dhe duke e pasur markën e FSC-së, ne dëshmojmë që jemi të përkushtuar edhe ndaj mjedisit dhe pyjeve.

Të gjitha produktet tona nga druri prodhohen sipas standardit EN ISO9000, për të siguruar që produktet të kenë të njëjtin kualitet vazhdimisht.

Që nga themelimi i saj, për më shumë se 25 vite me radhë, pronarët e shtëpive, ndërtuesit dhe kushdo që insiston në cilësi më të lartë për një ndërtim të ri apo rimodelim të dyerve dhe dritareve, ka vënë besimin në LESNA sepse produktet tona mund të dallohen nga cilësitë e tyre, mënyra e funksionimit dhe performancës, si dhe bukurinë e tyre.

Duke mbajtur fokusin mbi njerëzit si asetin tonë më të çmuar, LESNA vazhdon të prodhojë dyer dhe dritare të cilësisë më të lartë nën brendin tonë të respektuar dhe kjo dëshmohet edhe nga certifikatat tona ISO.

LESNA gjithashtu po bën emër edhe në industrinë e ndërtimit me një varg ndërtimesh të objekteve të larta në vend dhe rajon. Aktivitetet e saja së fundmi janë zgjeruar edhe në Shqipëri, Maqedoni, Kroaci, etj.

MJEDISI

Dyert dhe dritaret e drurit dhe dru/alumin nga LESNA prodhohen nga lënda e parë e cila vjen nga pyjet e certifikuara FSC nga furnizues të njohur. Ne e bëjmë sipërfaqen e drurit me një trajtim ekologjikisht miqësor. Së bashku me përdorimin e super qelqit me energji low-e, e ardhmja duket e ndritshme – nga prodhimi deri te përdoruesi i fundit për mjedisin tonë të përbashkët.

Druri i cilësisë së lartë është më i përshtatshëm se çdo material tjetër për prodhimin e dritareve dhe dyerve. Për ne është e rëndësishme se nga cili furnitor vjen druri që do të përpunohet. Prandaj, gjithmonë jemi furnizuar me dru nga pyjet e kontrolluara, ku shkalla e ripëllëzimit është më e madhe se ajo e prerjes.

SOCIALE

Në filozofinë e saj të biznesit, LESNA udhëhiqet nga një ekuilibër i drejtë mes konkurrencës ekonomike dhe zhvillimit social. Përgjegjësitë sociale janë të integruara në strategjitë dhe politikat e kompanisë, duke synuar krijim të vlerave për kompaninë, punonjësit si dhe shoqërinë në përgjithësi. Teknologjia e përzgjedhur për ngritjen dhe funksionimin e rrjetit përmbush maksimalisht standardet dhe direktivat e Komunitetit Evropian. Gjithashtu, që në fillimet e punës së saj, kompania LESNA ka treguar angazhim të plotë në mbrojtjen e mjedisit, duke menaxhuar me kujdes dhe efektivitet mbetjet si dhe duke përdorur në proceset e punës, në zyra dhe më gjerë, produkte dhe paketime të ricikluara. Ne synojmë që kjo politikë të pasurohet më tej me elemente të tjera miqësore për mjedisin, në proceset e ditëpërditshme të punës së kompanisë.

LESNA ka treguar në mënyrë të vazhdueshme kujdes të veçantë për mbështetjen dhe përkrahjen e nismave në dobi të shoqërisë, veçanërisht duke kontribuar për atë pjesë të popullsisë që nuk jetojnë në kushte normale dhe kanë nevojë për ndihmë e përkujdesje të veçantë. Për ne është e rëndësishme të tregojmë se jemi pranë shqiptarëve, jo vetëm nëpërmjet produkteve e shërbimeve që ofrojmë për ta, por edhe nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në zgjidhjen e disa prej problemeve, në përputhje me vlerat e kompanisë si dhe filozofinë drejtuese të LESNA.

Nismat në të cilat ne jemi përfshirë janë të shumta dhe ne do të angazhohemi gjithmonë në aktivitete apo veprimtari të cilat do të krijojnë vlera për shoqërinë dhe për qytetarët. Ne do të gjendemi gjithmonë aty ku do të ketë nevojë.

LESNA
DYER DHE DRITARE
| www.lesna.net





DRITARE NGA DRURI

LESNA prodhon dritare prej druri duke përdorur korniza të stilit evropian të cilat janë në përputhje me të gjitha standardet relevante të Kosovës dhe i përmbushin gjithashtu kërkesat e larta të CE Marking.

Aftësia për të prodhuar dritare të cilësisë së lartë është krijuar nga më shumë se 50 vite përvojë dhe traditë në përpunimin e drurit.



Lënda e parë e drurit është 100% e aprovuar nga FSC (Forest Stewardship Council) dhe duke e pasur markën e FSC-së, ne dëshmojmë që jemi të përkushtuar edhe ndaj mjedisit dhe pyjeve.

Të gjitha produktet tona nga druri prodhohen sipas standardit EN ISO9000, për të siguruar që produktet të kenë të njëjtin kualitet vazhdimisht.

Lesna është e certifikuar me standardet CE që garantojnë se të gjitha produktet përmbushin normat e përcaktuara evropiane të shëndetit, sigurisë dhe ambientit.

LLOJET E DRURIT

DRURI MERANT



Dritaret prodhohen duke përdorur teknika dhe makineri të përsosura për prodhim. Kjo ua jep produkteve një kualitet të lartë dhe eliminon gabime të mundshme në dritare.

Druri Merant i përket gjinisë apo klasës së drurit të fortë i cili kultivohet në Azinë Juglindore – Indonezi, Malajzi, etj.

Ngjyra e drurit të Merantit është zakonisht ngjyrë kafe me disa nuanca të të kuqes dhe me vija të herë-pas-herëshme.

Dritaret mund të bëhen me nuanca të mëposhtme:



DRURI ÇAM



Dritaret prodhohen duke përdorur teknika inxhinierike dhe makineri të përsosura për prodhim. Kjo ua jep produkteve një kualitet të lartë dhe eliminon gabime të mundshme në dritare.

Druri Çam është një dru i jashtëzakonshëm i njohur për bukurinë dhe karakteristikat unike të saj.

Ky dru është i butë dhe i lehtë për t'u përpunuar. Ngjyrat e saj mund të jenë të bardha dhe shpesh herë me një nuancë roze të lehtë. Tiparet e këtij druri janë të përshtatshme për prodhimin e dritareve.

Dritares i bëhet impregnimi si bazë mbrojtëse kundër kalbjes dhe mykut dhe përfundohet me një ngjyrë standarde të bardhë sipas RAL9010 dhe arrijnë një mbulesë totale prej 160 mikron (e thatë).

Ngjyrat e tjera shtesë bëhen sipas kërkesës së klientëve.

Në dispozicion janë gjithashtu edhe ngjyrat transparente (llak).



Xhami

Xhami termopan, të cilin ne përdorim është xham transparent 'Float' dhe Low-E, që do të thotë se është rezistent ndaj rrezeve të diellit dhe poashtu e mban nxehtësinë e brendshme gjatë dimrit.

Ky xham përmban një trashësi prej 4mm dhe hapësira në mes të xhamave, varësisht 2 apo 3 xhama, është e mbushur me gaz argon i cili është më izolues se ajri.



U-Vlera

Dritaret të cilat janë me nga 2 xhama dhe të mbushura me 16mm argon, vetëm xhami mund të arrij një U-Vlerë prej 1.1W/m2K, kurse komplet dritarja arrin një U-Vlerë prej 1.2 deri 1.4W/m2K.

Dritaret e mbushura me 22mm argon dhe respektivisht me nga 3 xhama, vetëm xhami mund të arrij një U-Vlerë prej 0.7W/m2K, kurse komplet dritarja arrin një U-Vlerë prej 1.0 deri 1.2W/m2K.



Mënyra e hapjes

Dritaret kanë një mekanizëm Roto NT/K. Ky mekanizëm e bën hapjen e dritareve më të lehtë dhe më të sigurt. Ky mekanizëm reziston peshën deri në 100 kg.

Mënyra e hapjes mund të bëhet vertikalisht dhe horizontalisht. Lartësia maksimale e hapjes është:

Hapja te dritaret e bardha: 2.40m

Hapja te dritaret me ngjyrë: 2.40m



Reduktimi i zhurmës

Së bashku me performancat e shquara të izolimit, vjen edhe një reduktim proporcional i transmetimit të zhurmës. Varësisht prej numrit të xhamave, 2 apo 3, reduktimi i transmetimit të zhurmës mund të arrihet deri në 30db.







Profili
68mm



Profili
78mm



Profili
92mm



DRITARE DRU DHE ALUMIN

LESNA prodhon dritare prej dru-aluminit duke përdorur korniza të stilit evropian të cilat janë në përputhje me të gjitha standardet relevante të Kosovës.

Aftësia për të prodhuar dritare të cilësisë së lartë është zhvilluar dhe avancuar nga përvoja 50 vjeçare në tregun e drurit.

Prodhimi i dritareve dru-alumin i kombinon tiparet më të mira të dy materialeve. Druri është i ngrohtë dhe si i tillë absorbon zhurmën mirë dhe kujdeset për rehati dhe ngrohtësi në shtëpinë tuaj. Ndërsa alumini është një produkt modern i teknologjisë së lartë, që është veçanërisht rezistent ndaj ndikimit të jashtëm. Shtresa e aluminit është relativisht e lehtë dhe nuk shton peshë shtesë në dritare.



Lënda e parë e drurit është 100% e aprovuar nga FSC (Forest Stewardship Council) dhe duke e pasur markën e FSC-së, ne dëshmojmë që jemi të përkushtuar edhe ndaj mjedisit dhe pyjeve.

Të gjitha produktet tona nga druri prodhohen sipas standardit EN ISO9000, për të siguruar që produktet të kenë të njëjtin kualitet vazhdimisht.

Lesna është e certifikuar me standardet CE që garantojnë se të gjitha produktet përmbushin normat e përcaktuara evropiane të shëndetit, sigurisë dhe ambientit.



DRURI

Dritaret prodhohen duke përdorur teknika dhe makineri të përsosura për prodhim. Kjo u jep produkteve një kualitet të lartë dhe eliminon gabime të mundshme në dritare.

LLOJET E DRURIT

DRURI MERANT



DRURI ÇAM



Dritaret mund të bëhen me nuancat e mëposhtme:

Mahagon
i mbyllët

Mahagon
i qelët

Polisander

Kafe e
mbyllët

Kafe e
qelët

Dritares i bëhet impregnimi si bazë mbrojtëse kundër të kalburit dhe mykut dhe përfundohet me një ngjyrë standarde të bardhë sipas RAL9010 dhe arrijnë një mbulesë totale prej 160 mikron (e thatë).

Ngjyrat e tjera shtesë bëhen sipas kërkesës së klientëve.

Në dispozicion janë gjithashtu edhe ngjyrat transparente (Llak).



ALUMINI

Shtresa e aluminit e cila integrohet në anën e jashtme të dritares është i trashë 1.5 mm. Kur pjesa e aluminit ngjitet në dritare, dritarja merr një gjerësi shtesë prej 18mm;

Ngjyra standarde e pjesës së aluminit është me një ngjyrë të bardhë sipas RAL9010.

Ngjyrat e tjera shtesë bëhen sipas kërkesës se klientëve.



Xhami

Xhami termopan, të cilin ne përdorim është xham transparent 'Float' dhe Low-E, që do të thotë se është rezistent ndaj rrezeve të diellit dhe poashtu e mban nxehtësinë e brendshme gjatë dimrit. Ky xham përmban një trashësi prej 4mm dhe hapësira në mes të xhamave, varësisht 2 apo 3 xhama, është e mbushur me gaz argon i cili është më izolues se ajri.



U VLERA

1.2W/m²K

U-Vlera

Dritaret të cilat janë me nga 2 xhama dhe të mbushura me 16mm argon, vetëm xhami mund të arrij një U-Vlerë prej 1.1W/m²K, kurse komplet dritarja arrin një U-Vlerë prej 1.2 deri 1.4W/m²K.

Dritaret e mbushura me 12mm argon dhe respektivisht me nga 3 xhama, vetëm xhami mund të arrij një U-Vlerë prej 0.7W/m²K, kurse komplet dritarja arrin një U-Vlerë prej 1.0 deri 1.2W/m²K.



Mënyra e hapjes

Dritaret kanë një mekanizëm Roto NT/K. Ky mekanizëm e bën hapjen e dritareve më të lehtë dhe më të sigurt. Ky mekanizëm reziston peshën deri në 100 kg.

Mënyra e hapjes mund të bëhet vertikalisht dhe horizontalisht. Lartësia maksimale e hapjes është:

Hapja te dritaret e bardha: 2.40m

Hapja te dritaret me ngjyrë: 2.40m



Reduktimi i zhurmës

Së bashku me performancat e shquara të izolimit, vjen edhe një reduktim proporcional i transmetimit të zhurmës. Varësisht prej numrit të xhamave, 2 apo 3, reduktimi i transmetimit të zhurmës mund të arrihet deri në 30db.

SISTEMET



Profili
68mm

Sistemi Standard



Profili
78mm

Sistemi Standard



Profili
92mm

Sistemi Standard



Complanare



Sistemi 5000 S



Sistemi zero



Termoscudo, Easy Line





LESNA PVC

Dritaret tona të cilat prodhohen sipas standardeve të larta, janë teknologjikisht më të avancuarat në Kosovë, duke përfshirë profile të Aluplast të cilat janë termikisht efikase në ruajtjen e energjisë.

LESNA prodhon dritare të cilat janë me performanca të larta. Dizajni apo profilet e tyre janë të punuara në mënyrën më të mprehtë dhe të zgjuar.



DIZAJNET APO PROFILET

Linja aktuale e prodhimit bazohet në IDEAL 5000 dhe IDEAL 8000.

IDEAL 5000



Një karakteristikë e sistemit të profilit IDEAL 5000 (Aluplast) është përdorimi i kornizës standarde me një sistem i cili përbëhet nga 6 mure dhe 5 komore (hapësira) përbrenda, të cilat njëkohësisht garantojnë edhe për termoizolim. Dimenzioni i profilit është 70mm i gjerë.

Dimensionet maksimale dhe minimale:

Me 2 xhama dhe 3 goma:

Xhami: 4mm
Hapësira në mes xhamave: 16mm
(4mm (xh)+16mm(h)+4mm(xh))

Dimensioni minimal:

400mm (gjerësi),
400mm (lartësi)

Dimensioni maksimal:

1100mm (gjerësi), 2400mm (lartësi) (bardhë)
1100mm (gjerësi), 2250mm (lartësi) (me ngjyrë)

IDEAL 8000



Një karakteristikë e sistemit të profilit IDEAL 8000 (Aluplast) është përdorimi i kornizës standarde me një sistem i cili përbëhet nga 7 mure dhe 6 komore (hapësira) përbrenda, të cilat njëkohësisht garantojnë edhe për termoizolim. Ky sistem posedon 3 goma dhe 3 xhama. Dimenzioni i profilit është 85mm i gjerë.

Me 3 xhama:

Xhami: 4mm
Hapësira mes xhamave: 10mm + 12mm
(4mm(xh)+10mm(h)+4mm(xh)+12mm(h)+4mm(xh))


Dimensioni minimal:

400mm (gjerësi), 400mm (lartësi)

Dimensioni maksimal:

1100mm (gjerësi), 2400mm (lartësi) (bardhë)1100mm
(gjerësi), 2250mm (lartësi) (me ngjyrë)

Të gjitha dimensionet tjera duke përfshirë edhe atë fikse,
bëhen sipas kërkesës.



Xhami

Xhami termopan, të cilin ne përdorim është xham transparent 'Float' dhe Low-E, që dot të thotë se është rezistent ndaj rrezeve të diellit dhe poashtu e mban nxehtësinë e brendshme gjatë dimrit. Ky xham përmban një trashësi prej 4mm dhe hapësira në mes të xhamave, varësisht 2 apo 3 xhama, është e mbushur me gaz argon i cili është më izolues se ajri.



Diktungu (Goma)

Përveç disa përjashtimeve të rralla, profilet kryesore kanë Diktungun (gomën) përbrenda në kornizë. Këto korniza e kanë diktungun të integruar fabrikisht dhe ato ndihmojnë në normalizimin e ngrohjes si dhe në ndalimin e zhurmës nga jashtë.

U VLERA
1.2W/m²K

U-Vlera

Dritaret të cilat janë me nga 2 xhama dhe të mbushura me 16mm argon, mund të arrijnë një U-Vlerë deri në 0.9W/m²K.

Dritaret e mbushura me 22mm argon dhe respektivisht me nga 3 xhama, mund të arrijnë një U-Vlerë deri në 0.7W/m²K.



Mënyra e hapjes

Dritaret kanë një mekanizëm Roto NT/K. Ky mekanizëm e bën hapjen e dritareve më të lehtë dhe të sigurt. Ky mekanizëm reziston peshën deri në 100 kg.


Mënyra e hapjes mund të bëhet vertikalisht dhe horizontalisht. Lartësia maksimale e hapjes është: Hapja te dritaret e bardha: 2.40 m Hapja te dritaret me ngjyrë: 2.25 m



Reduktimi i zhurmës

Së bashku me performancat e shquara të izolimit, vjen edhe një reduktim propocional i transmetimit të zhurmës. Reduktimi i transmetimit të zhurmës mund të arrihet deri në 30db.





NGJYRAT

Ngjyra standarde është e bardhë, ngjyrë bungu e arit dhe mahagon. LESNA gjithashtu ofron dritare me ngjyra të tjera, varësisht sipas porosisë.

REKUIZITAT

- Përshkueshmëria e ajrit: deri në Klasa: 4 (DIN EN 12207)
- Qëndrueshmëria ndaj shiut: deri në Klasa: 9A (DIN EN 12208)
- Rezistent ndaj ngarkesës së erës: deri në Klasa: C5 (DIN EN 12210)
- Rezistent ndaj zhurmës (te xhamat 2x4mm apo 3x4mm) korrespondojnë njësitë izoluese: $R_w = 30\text{dB}$ sipas: EN 14351-1
- Ruajtja e ngrohtësisë: (DIN EN ISO 10077-1)

LESNA prodhon dritare që përputhen me BS7412: 2007, standard që përfshin fabrikimin e dritareve PVC, dhe BS7950, standard për siguri.





LESNA DYER TË HYRJES

Me një reputacion të themeluar për angazhim për të dizajnuar në mënyrë inovative, zejtari të patejkalueshme dhe shërbim të shkëlqyer ndaj klientit, LESNA ka projektuar, prodhuar dhe ndërtuar dyer të hyrjes të besueshme dhe me stil për shtëpi, apartamente dhe ndërtesa në gjithë Kosovën për më shumë se 50 vjet.

Dyert e hyrjes prej druri janë të një kualiteti të lartë, të cilat përputhen me standardet evropiane, dhe gjithmonë iu përgjigjen kërkesave të konsumatorëve.



Lënda e parë e drurit është 100% e aprovuar nga FSC/PEFC dhe duke e pasur markën e FSC/PEFC, ne dëshmojmë që jemi të përkushtuar edhe ndaj mjedisit dhe pyjeve.



Të gjitha produktet tona nga druri prodhohen sipas standardit EN ISO9000, për të siguruar që produktet të kenë të njëjtin kualitet vazhdimisht.



Lesna është e certifikuar me standardet CE që garantojnë se të gjitha produktet përmbushin normat e përcaktuara evropiane të shëndetit, sigurisë dhe ambientit.



MATERIALI

Dyert prodhohen duke përdorur teknika dhe makineri të përsosura për prodhim. Kjo ua jep produkteve një kualitet të lartë dhe eliminon gabime të mundshme në dyer.

Llojet e drurit të cilat përdoren për prodhimin e dyerve janë druri Merant dhe druri Çam, si dhe plastika, varësisht nga kërkesa e klientëve.

Druri Merant i përket gjinisë apo klasës së drurit të fortë i cili kultivohet në Azinë Juglindore – Indonezi, Malajzi, etj.

Ngjyra e drurit të Merantit është zakonisht e kaftë me disa nuanca të kuqe dhe me vija të herë-pas-hershme.

Druri Çam është një dru i jashtëzakonshëm i njohur për bukurinë dhe karakteristikat unike të saj.

Ky dru është i butë dhe i lehtë për t'u përpunuar. Ngjyrat e saj mund të jenë të bardha dhe shpeshherë me një nuancë roze të lehtë. Tiparet e këtij druri janë të përshtatshme për prodhimin e dritareve.

MODELET

Modelet dhe dizajnet e dyerve të hyrjes bëhen varësisht nga kërkesat e konsumatorëve. Ato mund të jenë me xham apo me mbushje druri (tablla druri).



Xhami

Xhami termopan, të cilin ne përdorim është xham Low-E, që do të thotë se është rezistent ndaj rrezeve të diellit dhe poashtu e mban nxehtësinë e brendshme gjatë dimrit. Ky xham ka një trashësi prej 4mm dhe hapësira në mes të xhamave, varësisht 2 apo 3 xhama, është e mbushur me gaz argoni cili është më izolues se ajri.



U-Vlera

Varësisht nga preferenca e konsumatorëve për dizajnin apo modelin e dyerve, U-Vlera është gjithmonë e ulët.



Reduktimi i zhurmës

Së bashku me performancat e shquara të izolimit, vjen edhe një reduktim proporcional i transmetimit të zhurmës.





Dru Merant
Ngjyra: Polisander



Dru Merant
Ngjyra: E bardhë



Dru Merant
Ngjyra: Mahagon i çelët



Dru Merant
Ngjyra: Kafë e çelët



Plastikë (PVC)
Ngjyra: E artë



LESNA ROLETA

LESNA ofron Roleta moderne dhe cilësore prej alumini të cilat janë të forta, të sigurta dhe të qëndrueshme në çfarëdo kushte atmosferike.

MODELET E ROLETAVE NGA LESNA

- Roleta të Jashtme
- Roleta të Brendshme



ROLETA TË JASHTME

Ky lloj i profilit të roletave është i jashtëm që nënkupton se kutia e roletave është e integruar jashtë shtëpisë.

Materiali i kutisë të këtij lloji është prej alumini.

Fletat e roletave janë 37mm të lartë dhe 8mm të gjerë dhe të mbushura me izolim.

ROLETA TË BRENDSHME

Ky lloj i profilit të roletave është i brendshëm që nënkupton se kutia e roletave është e integruar brenda shtëpisë.

Materiali i kutisë të këtij lloji është prej PVC dhe përkundër asaj të profilit të roletave të jashtme, kjo kuti është e mbushur me stiropor që ndihmon izolim termik.

Fletat e roletave janë 37mm të lartë dhe 8mm të gjerë dhe të mbushura me izolim.

ENERGJI EFICIENTE

Ndërtimi apo konstruksioni i këtyre roletave, fletat e të cilave janë të mbushura me izolim, mbrojnë dhomat nga rrezet solare dhe në këtë mënyrë e mbajnë dhomën të freskët në muajt e ngrohtë të verës.

Në të kundërtën, lëshimi apo mbyllja e roletave gjatë kohës së dimrit jo vetëm se e bënë dhomën të duket më komode, por në fakt mund ta bëjë atë edhe të ngrohtë.





MUNDËSITË E HAPJES SË ROLETAVE

Këto Roleta ofrojnë tri mundësi të ndryshme për hapje (palosje) dhe mbyllje (shpalosje) të roletave;

1. Me motor
2. Me shirit
3. Me kalem

Lesna sh.p.k
Lidhja e Pejës nr 133
10000 Prishtinë-Kosovë
Tel. +381 (0) 38 601 701
Fax. +381 (0) 38 601 705
web: www.lesna.net

